



*KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS SH. a.  
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.  
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.*

**KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS SH.A.**

**APLIKIMI TARIFOR PËR  
VITI 2012**

**Pjesa V – Aplikimi Tarifor i Furnizuesit Publik të Energjisë  
Elektrike**

**13 janar 2012**

## Përmbajtja

I.	Hyrje .....	3
A.	Përmbledhje .....	3
B.	Bilanci Energjetik .....	3
C.	Definicionet .....	4
II.	Rregullat për Vendosije dhe Metodologjia Tarifore .....	5
A.	Rregulla e Vendosijes së Çmimeve .....	5
B.	Metodologjia Tarifore .....	5
III.	Të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM) .....	5
A.	Kostot që do të mbuloohen nga Furnizuesi Publik .....	5
a)	Kostot e Operimit dhe Mirëmbajtjes .....	7
b)	Konsumi i Brendshëm i Energjisë Elektrike .....	7
c)	Zhvlerësimi i Lejuar (DEPC) .....	7
d)	Pikat e tjera për t'u përfshirë në Kostot e Shitjes me Pakicë .....	7
e)	Lejimi i Kapitalit Punues .....	8
B.	TOTALI I HLM që do të mbulohet nga Furnizuesi Publik në Tarifat me Pakicë .....	9
IV.	Shpërndarja e HLM .....	11
V.	Përcaktimi i Çmimeve Kosto Reflektive sipas Grupit Tarifor .....	12
VI.	Përshtatja e Rekomanduar sipas Grupit Tarifor .....	13
	Shtojca A – Përcaktuesit e Faturimit dhe të Hyrat 2012 në Tarifat Aktuale .....	18
	Shtojca B – Shpërndarja e të HLM në Kategoritë Tarifore .....	21

## **I. Hyrje**

### **A. Përmbledhje**

Ky Aplikim dorëzohet në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) të Kosovës nga Furnizuesi Publik i Energjisë Elektrike (FPEE) për aprovim e:

- A. Kosmos së rregulluar të Furnizuesit Publik, përfshirë Kostot e Shitjes me Pakicë dhe Kostot e Kapitalit Punues;
- B. Tarifave të rregulluara të propozuara për konsumatorët me pakicë që marrin shërbime nga FPEE.

### **B. Bilanci Energjetik**

Në mënyrë që të llogariten kostot dhe të hyrat, Bilanci Energjetik zyrtar duhet të merret se pikënisje. Bilanci energjetik përshkruan sasinë e energjisë, të matur në KWh (ose MWh) e cila pritët të ofrohet te FPEE nga gjeneratorët e rregulluar dhe shitjet e energjisë te konsumatorët. Tabela 1 ofron një përmbledhje të bilancit përfundimtarë të energjisë siç jemi pajtuar me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, ZRRE dhe KOSTT-in.

**Tabela 1 – Përmbledhja e Bilancit të Energjisë për vitin 2012**

Linja	Hyrja/Dalja	Sasia
Nr.	Përshkrimi	GWH
1	Kosova A Gjenerimi Neto (Neto me të gjitha shpenzimet vetanake)	1,475.3
2	Kosova B Gjenerimi Neto (Neto me të gjitha shpenzimet vetanake)	3,392.5
3	Gjenerimi nga Ujmani	82.0
4	Importet	820.8
5	<b>Totali në Sistemin e Transmisionit (1 + 2 + 3 + a4)</b>	<b>5,770.6</b>
6	Shitjet nga Transmisioni	744.6
7	Shfrytëzimi nga KEK-u	20.4
8	Minierat	111.0
9	Eksportet	169.8
10	Humbjet në Transmision	128.2
11	Teprica	13.3
12	<b>Totali nga Transmisioni (6 + 7 + 8 + 9 + 10 + 11)</b>	<b>1,187.3</b>
13	<b>Neto në Sistemin e Shpërndarjes (5 - 12)</b>	<b>4,583.3</b>
14	Gjeneratorët e kyçur në Sistemin e Shpërndarjes	51.5
15	Energjia e furnizuar nga KOSTT-i në Veri të Kosovës	203.7
16	Humbjet Teknike te Shpërndarjes	796.9
17	Humbjet Komerçiale te Shpërndarjes	723.2
18	<b>Neto për shitjet në Nivelin e Shpërndarjes (13 + 14 - 15 - 16-17)</b>	<b>2,911.0</b>
19	<b>Shitjet në Nivel të Shpërndarjes</b>	
20	35 kV	40.1
21	10 kV	205.0
22	0.4 kV	2,665.8
23	<b>Totali (20+21+22)</b>	<b>2,910.9</b>

### C. Definicionet

Me përjashtim kur theksohet ndryshe, definicionet e termeve në këtë dokument janë të njëjta me ato në ligjet e energjisë së Kosovës dhe ato që përmenden në Rregullat për Vendosjen e Çmimeve, të miratuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji.

## **II. Rregullat për Vendosjen e Çmimeve dhe Metodologjia Tarifore**

Ky seksion përshkruan mënyrën se si ky Aplikim Tarifor është në përputhje me Rregullat për Vendosjen e Çmimeve dhe Metodologjinë e propozuar Tarifore të dorëzuar për aprovim në ZRRE nga ana e KEK-ut.

### **A. Rregulla për Vendosjen e Çmimeve**

Në nëntor të vitit 2011, ZRRE ka aprovuar “Rregullën për Vendosjen e Çmimeve të Furnizuesit Publik të Energjisë Elektrike (Rregulla për Çmimet e FPEE-së)”. Kjo Rregull zëvendëson “Rregullën mbi Parimet e Llogaritjes së Tarifave në Sektorin e Energjisë Elektrike (Rregulla e Çmimeve)” dhe “Metodologjinë Tarifore për Sektorin e Energjisë Elektrike” e cila ishte aprovuar nga ZRRE më 15 dhjetor 2005.

### **B. Metodologjia Tarifore**

#### **II. Të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM)**

##### **A. Kostot që do të mbuloohen nga Furnizuesi Publik.**

Rregulla e Çmimeve të FPEE përshkruan formulën për llogaritjen e HLM, për qëllim të tarifave me pakicë në fillim të Periudhës Rregulative si në vijim:

$$MAR_t = OPMC_t + DEPC_t + RTNC_t + LSSC_t + LICC_t + KREV_t$$

Kjo formulë i bën bashkë të gjitha kostot e të gjithë të licencuarve në këtë sektor, përfshirë:

- Gjeneratorin Publik
- Operatorin e Sistemit të Transmisionit
- Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes
- Furnizuesin Publik.

Në këtë seksion, ne do të dokumentojmë kostot e FPEE, në mënyrë që të kemi bazën për përcaktimin e total të HLM.

Tabela 2 ofron detajet për përcaktimin e kostove të FPEE-së. Poshtë tabelës është paraqitur sqarimi për mënyrën në të cilën janë zhvilluar kostot.

**Tabela 2 – Kostot e Furnizuesit Publik**

**KOSTOT E FURNIZUESIT PUBLIK TE ENERGJISE ELEKTRIKE**

Vlera Eurove ne mijera pervec vleres se njesive

Te gjitha kostot te bazuara ne vitin 2012

**Kostot me Pakice te Furnizuesit Publik**

Operimi dhe Mirembajtja		<b>10,707</b>
Alokimi ne Kostot e Administrates Qendrore		<b>1,871</b>
Konsumi Intern in Energjise:		
Konsumi nga Bilanci Energjise (GWH)	33.7	
Çmimi (Euro per MWH)	38.65	
Kostoja Energjise se Shfrytezimit Intern		<b>1,303</b>

Baza e Aseteve te Rregulluara per qellime te zhvleresimit:		
Kostoja me 01 Jan 2012	4,832	
Shtesat 2012	395	
Kostoja me 31 Dhje 2012	5,227	
<b>Zhvleresimi per vitin 2012</b>		<b>1,006</b>
Jetegjatesia e aseteve ne 2012	5	
Zhvleresimi Akum. me 01Jan12	2,972	
Zhvleresimi per vitin 2012	1,006	
Zhvleresimi Akum. me 31Dhje12	3,978	

**Rregullimet ne Kostot me Pakice:**

Llogaria Balancuese e Tarifave nga 2011	(11,016)	
Margzha e fituar nga shitjet interne (Mihje, Gjen)	(4,942)	
Rregullimet per nen-shpenzim te CAPEX ne 2011	<u>(33)</u>	
Total Rregullimet		<b>(15,991)</b>

**TOTAL KOSTOT ME PAKICE**

**(1,105) = RETR**

**Kostoja e Kapitalit te Punes**

**Baza per Kapital te Punes:**

Kostot me Pakice	(1,105)	
Ener.me shumice per Konsum.me Pakice	141,242	
Ngarkesa Transmisionit	11,300	
Ngarkesa per Shfryt. te Sis. te Shperndarjes	87,477	
Ngarkesa per Licensa	<u>0</u>	
Kapitali Punes (Vjetore)		238,914
Baza per Kapital te Punes (1/12)		19,910

**Norma e Aplikuar per KP**

Eurobor (norma 3 mujore)	1.3%	
S (shtesa)	<u>5.7%</u>	
Norma aplikuar (e barabarte me normen ne disponim per FPEE)		7.0%

**KOSTOJA E LEJUAR E KAPITALIT TE PUNES**

**1,365 = WCLC**

**Shpenzimi per Borgj te Keq**

Te hyrat e Lejuara pa Borgj te Keq	227,279	
Perqindja e Borgjit te Keq te lejuar	<b>5%</b>	<b>= BDTA</b>
Lejimi i Bogjit te Keq ne Tarifa me Pakice		<b>11,962</b>

**TOTAL KOSTOJA E FURNIZIMIT PER KONSUMATORET E RREGULLUAR**

**12,222**

#### **a) Kostot e Operimit dhe Mirëmbajtjes**

Kostot e O&M për Furnizim në vitin 2012 (10.7 milion €) janë ato që përfshihen në buxhetin e KEK-ut për vitin 2012. Kjo është më e lartë se sa 9.1 milion € të aprovuara nga ZRRE në rishikimin tarifor të vitit 2011, fillimisht për shkak të faktit se kostot e personelit ishin bazuar në nivelet e disa viteve më parë dhe nuk kishin ndryshuar.

Shpërndarja e kostove të Zyrës Qendrore në Furnizim (1.9 milion €) është pak më e lartë se sa shumë që e ka aprovuar ZRRE në vitin 2011. Metoda e shpërndarjes (alokimit) është e njëjtë sikur në rishikimet e mëparshme tarifore.

#### **b) Konsumi i Brendshëm i Energjisë Elektrike**

Konsumi i brendshëm i energjisë elektrike për zyrat e distrikteve, arkat dhe objektet e KEK-ut duhet të regjistrohet si kosto në mjedisin e ri të shthurur dhe ajo rezulton në një kosto prej 1.3 milion €, siç është paraqitur në Tabelën 2.

#### **c) Zhvlerësimi i Lejuar (DEPC)**

Rregullat e reja të vendosjes së çmimeve kanë ridefinuar Bazën e Aseteve të Rregulluara dhe i kanë përfshirë asetet para vitit 2006 në RAB. Pjesa I e Aplikimit Tarifor të KEK-ut ka siguruar një dokumentim të RAB-it deri me 31 dhjetori 2011. Duke e përdorur këtë si pikë fillestare, shtesat kapitale të vitit 2012 prej 395,000 € janë shtuar dhe zhvlerësimi për vitin 2012 është bazuar në bilancin mesatar të mjeteve themelore dhe jetëgjatësinë 5 vjeçar të asetëve të furnizimit, për të krijuar një vlerë prej 1.0 milion € për zhvlerësim në vitin 2012.

#### **d) Pikat e tjera për t'u përfshirë në Kostot e Shitjes me Pakicë**

Kostot e furnizimit për vitin 2012 duhet të përfshijnë tre përbërës shtesë.

- Në vendimin tarifor të vitit 2011, ZRRE ka vlerësuar se të hyrat aktuale të vitit 2011 për KEK-un do të ishin më të larta se të hyrat e lejuara të vitit 2011 për 11 milion € dhe e ka kategorizuar këtë si "Llogaria Balansuese e traifave (LBT)" e cila do të përdoret për mënjanimin e rritjeve të kostove në vitin 2012. Ajo kredi është paraqitur si reduktim në Kostot e Furnizimit prej 11,016,000 €, duke zvogëluar kështu HLM për vitin 2012.
- Në mënyrë që të shthuren si duhet kostot e të licencuarve të ndryshëm, energjia e përdorur nga entitetet e Minierave dhe Gjenerimit është caktuar me çmimin e kostove me pakicë (meqë energjia furnizohet dhe matet në tensione të ndryshme të shpërndarjes). Të hyrat e tepërta të kostos së shitjes me shumicë të energjisë janë paraqitur si kredi, me efektin që të kompensojë një pjesë të kostove të transmisionit, shpërndarjes dhe furnizimit që do t'i ngarkohen konsumatorëve të rregulluar.

- Meqë KEK-u nuk e ka shpenzuar shumën totale të Shpenzimeve Kapitale (CAPEX) të lejuara në tarifat e vitit 2011, në vitin 2012 duhet të bëhet një rregullim, në mënyrë që të pasqyrohet reflektimi dhe kthimi në shumën e pashpenzuar.

**Në saxe të, fillimisht ndikimit të konsiderueshëm të kredisë për Llogarinë Balancuese të Tarifave (LBT) nga viti 2011, Kostot me Pakicë të Furnizuesit Publik për vitin 2012 janë kredi e 1,105,000 €. KEK-u propozon që ZRRE ta aprovojë këtë shumë.**

#### **e) Lejimi i Kapitalit Punues**

Përveç Kostove me Pakicë, Rregulla e Çmimeve lejon që FPEE të përfshijë një Lejim të Kapitalit Punues në tarifat me pakicë. Siç është paraqitur në tabelën 2, baza për Lejimit e Kapitalit Punues përfshin:

- Kostot e Shitjes me Pakicë
- Koston e Energjisë me Shumicë për Konsumatorët me Pakicë
- Taksat e Transmisionit që i paguhen OST-së
- Taksat e Shfrytëzimit të Sistemit të Shpërndarjes që i paguhen OSSH-së
- Taksën e Licencës së ZRRE-së

Shuma vjetore e këtyre kostove (239 milion €) shumëzohet me 1/12, duke njohur nevojën për 30 ditë të kostove operuese, ashtu siç është specifikuar në Rregullën e Çmimeve. Në komentet e KEK-ut për ZRRE-në gjatë procesit të konsultimit për rregullat e çmimeve, KEK-u ka kërkuar që ZRRE të lejojë së paku 45 ditë lejim, megjithatë ZRRE ka vendosur për lejimin 30 ditësh për rregullimin përfundimtar.

Norma e aplikuar për nivelin e kapitalit punues është specifikuar në rregullën e çmimeve si në vijim:

Kostoja e financimit të kapitalit punues do të llogaritet si EUROBOR plus 5%, ku S është një vlerë që do të përcaktohet nga Rregullatori në Përditësimet (Azhurnimet) Vjetore dhe e cila pasqyron preminë e pagueshme nga i licencuari për huat afatshkurta.

Norma e "European Banking Federation Interbank Offer Rate" (EURIBOR) për depozitat e Euros për një periudhë të barabartë me 3 muaj ishte rreth 1.3% që nga 6 janari 2012, pika më e ulët që nga prilli i vitit 2011, sipas shërbimit të lajmeve "Reuters". Meqë kostoja e financimit afatshkurtër për KEK-un është rreth 7%, vlera e duhur për S është 5.7%. Siç është paraqitur në Tabelën 2, lejimi i rekomanduar i kapitalit punues për vitin 2012 është 1.4 milion €.

#### **f) Shpenzimi i Borxhit të Keq**

Për vitin 2011, KEK-u do të inkasojë rreth 20 milion € më pak se shuma e faturuar, që rezulton në rreth 10% të shpenzimit të borxhit të keq. Në vendimin tarifor 2011, ZRRE ka lejuar KEK-un që të rikthejë 5 milion € të borxhit të keq në tarifa, rreth 2.5% të të hyrave të faturuara. Për vitin 2012, KEK-u kërkon një lejim të borxhit të keq prej 5%, rreth gjysma e shumës që pritet në vitin 2011. Kjo njeh kushtet e vështira ekonomike të niveleve të larta të varfërisë dhe papunësisë, duke i dhënë FPEE-së një mori stimulimesh për rritjen e inkasimeve. Tabela 3 paraqet shpenzimin e borxhit të keq prej 12 milion €, 5% e të HLM.

**Kostot e rekomanduara që do të mbulohen nga Furnizuesi Publik janë 12,222,000 € dhe KEK kërkon nga ZRRE-ja që ajo shumë të aprovohet.**

**B. Totali i të Hyrave të Lejuara Maksimale ( HLM) që do të mbulohet nga Furnizuesi Publik në Tarifat me Pakicë.**

Totali i të Hyrave të Lejuara maksimale (HLM) që do të mbulohet në tarifa përfshin kostot e të gjithë të Licencuarve në këtë sektor si në vijim:

- Gjeneratori Publik – i dokumentuar në Pjesën II të Aplikimit Tarifor të KEK-ut
- Kostoja e Energjisë Elektrike me Shumicë - e dokumentuar në Pjesën III të Aplikimit Tarifor të KEK-ut
- Kostot e Transmisionit – të adresohen nga KOSTT-i, kostoja është vlerësuar këtu
- Shfrytëzimi i Sistemit të Shpërndarjes – është dokumentuar në Pjesën IV të Aplikimit Tarifor të KEK-ut
- Kostot e Furnizuesit – janë dokumentuar në seksionin e mësipërm të këtij aplikimi

Tabela 3 përmban të gjitha kostot e mësipërme dhe dokumentet për të HLM në vitin 2012 sipas përbërësve në Shtojcën 1 të Rregullës së Çmimeve të FPEE-së.

**Tabela 3 – HLM për 2012 i propozuar për Mbulimin e Tarifave me Pakicë**  
**TE HYRAT MAKSIMALE TE LEJUARA PER TARIFA ME PAKICE**  
 Vlera e Eurove ne mijera perveç per vlerat e njesive

$$MAR_t = (RETR_t + WCLC_t + WHPC_t + PSTC_t - NTFR_t + KREV_t) / (1 - BDTA_t)$$

<b>Kostot e lejuara me Pakice</b>		<b>RETR =</b>	<b>(1,105)</b>
<b>Kostot e lejuara te Kapitalit te punes</b>		<b>WCLC =</b>	<b>1,365</b>
<b>Kostot e lejuara te energjise me shumice</b>		<b>WHPC =</b>	<b>141,242</b>
Shitjet tek konsumatoret 220 & 110 KV (GWH)	744.6		
çmimi me shumice - Transmision (€/MWH)	38.59		
Kostoja e Energjise		28,734	
Shitjet tek konsumatoret distributiv (GWH)	2910.941		
Cmimi me shumice - Shperndarje (€/MWH)	38.65		
Kostoja e Energjise		112,508	
<b>Kostot kaluese</b>		<b>PSTC =</b>	<b>98,777</b>
Ngarkesat per Transmision	11,300		
Ngarkesat per shfrytezim te sistemit te shperndar	87,477		
Ngarkesat per Licensa	0		
<b>Te hyrat Jo- tarifore</b>	(Subv.per import te energjise)	<b>NTFR =</b>	<b>(13,000)</b>
<b>Faktori rregullues i te hyrave</b>		<b>KREV =</b>	<b>0</b>
<b>Total te hyrat e lejuara para shpenzimit te borgjit te keq</b>			<b>227,279</b>
<b>Perqindja e lejuar per borgj te keq</b>		<b>BDTA =</b>	<b>5.0%</b>
<b>TOTAL KERKESA PER TE HYRAT E LEJUARA</b>		<b>MAR =</b>	<b>239,241</b>

HLM të kërkuar prej 239,241,000 € për vitin 2012 në tabelën e mësipërme është e bazuar si në vijim:

- Kostot e Lejuara me Pakicë dhe kostot e Kapitalit Punues janë dokumentuar në seksionin e mëparshëm
- Kostot e Energjisë së Lejuar me Shumicë janë dokumentuar në Pjesën III të Aplikimit Tarifor të KEK-ut. Ato çmime për njësi që aplikohen në shitjet për konsumatorët e transmisionit dhe shpërndarjes për të arritur në 141.2 milion €.
- Kostot e bartshme prej 98.8 milion € përbëhen prej taksave të vlerësuar të transmisionit që do t'i ngarkohen Furnizuesit Publik prej 11.3 milion €, të cilat do të përshtaten kur ZRRE aprovon tarifën e transmisionit për KOSTT-in. Taksat e Shfrytëzimit të Sistemit të Shpërndarjes prej 87.5 milion €, të cilat janë dokumentuar në Pjesën IV të aplikimit tarifor të KEK-ut, janë kosto të tjera bartëse.
- Furnizuesi Publik nuk ka ndonjë të ardhur jo-tarifore nga palët e treta. Siç është diskutuar në Pjesën III të aplikimit tarifor të KEK-ut, megjithatë Subvencioni i Energjisë së Importuar që është pritur nga Qeveria e Kosovës (13 milion €) nuk është përfshirë në koston e energjisë me

shumicë, në mënyrë që të ruhet kostoja e vërtetë. Subvencioni është përfshirë si e ardhur jo-tarifore dhe KEK-u propozon që kjo shumë të alokohet plotësisht te konsumatorët shtëpiakë ashtu siç do të diskutohet në seksionin e ardhshëm.

- Lejimi i borxhit të keq është paraqitur si 5%, lejimi i kërkuar në pajtim me rregullën e re të çmimeve.

Përcaktuesit e Faturimit të 2012, bazuar në shitjet që përfshihen në Bilancin Energjetik janë paraqitur në Bashkëngjitjen A. Kur tarifat aktuale me pakicë aplikohen në përcaktuesit e faturimit, rezultati është një shumë për të ardhurat e faturuar prej 194,254,000 €. Në mënyrë që të mbulohen HLM e kërkuar prej 239,241,000 €, kërkohet një rritje tarifore prej 45 milion € (23%).

Ngritja tarifore në vlerë prej 45 milion Euro është tërësisht rezultat i dy çështjeve:

1. Përfshirja e aseteve para vitit 2006 për mbulimin e kostos në përputhje me rregullat e reja të çmimeve të cilat KEK-u i mbështet. Ndikimi i përfshirjes së këtyre aseteve në përcaktimin e zhvlerësimit dhe kthimit është përafërsisht 25 milion Euro.
2. Në vendimin për tarifa për vitin 2011, ZRRe-ja ka përfshirë 50 milion Euro të kostos së importit të zvogëluar për vlerën prej 27 milion Euro të subvencionuar nga Qeveria. Në këtë aplikim tarifor, KEK ka përfshirë koston e importit në vlerë prej 57 milion Euro të zvogëluar për vlerën prej 13 milion Euro të subvencionuar nga Qeveria që është e përfshirë në Buxhetin e Qeverisë 2012. Përfundimi është se në vitin 2012, do të kemi një vlerë neto prej 44 milion Euro të përfshirë në tarifa për kosto të importit krahasuar me 23 milion Euro të vitit të kaluar, ku ndryshimi është 21 milion Euro.

Në fakt, KEK-u ka përfshirë zvogëlimet e kostos së shpenzimeve Operative dhe të Mirëmbajtjes në këtë aplikim tarifor së bashku me një zvogëlim të theksuar të humbjeve komerciale. Këto zvogëlime të kostos do të kalohen tek konsumatorët në formë të kostove më të ultë në të HLM.

Seksioni IV i këtij dokumenti alokon HLM të kërkuar në kategoritë tarifore sipas kostove të shthurura të paraqitura në Tabelën 3 dhe bazuar në metodologjinë për përcaktimin e tarifave kosto reflektive, të zhvilluara nga KEK-u dhe që ia janë prezantuar ZRRE-së në aplikim tarifor 2011.

**SHËNIM:** Në rast se ZRRE përcakton se një rritje tarifore prej 23% e që në aspektin social mundë të jetë e pa pranueshme, KEK-u propozon që të përdoret një mekanizëm shumë transparent “zbutës, për të parandaluar ngritjen e madhe të çmimeve. Ai propozim është diskutuar më vonë në këtë aplikim.

#### **IV. Shpërndarja e HLM**

Shpërndarja (alokimi) i të HLM përmban shpërndarjen e Të Hyrave të Lejuara për secilën kategori tarifore të konsumatorëve. Qëllimi i kësaj shpërndarje është që të ndahen në mënyrë sa më të drejtë të mundshme kostot totale (Të Hyrat e Lejuara Maksimale) nëpër kategoritë e konsumatorëve, ashtu që secila kategori e konsumatorëve të paguajë pjesën e vet që i takon nga kostot e përgjithshme (Tarifat Kosto Reflektive).

Shtojca B përshkruan shpërndarjen e të HLM në secilën kategori tarifore. KEK-u ka përgatitur një analizë të detajzuar të përbërësve vijues për tarifat e shthurura me pakicë:

- Çmimi i energjisë elektrike me shumicë
- Shërbimet e Transmisionit
- Shfrytëzimi i Sistemit të Shpërndarjes sipas nivelit të tensionit shpërndarës
- Kostot e Furnizuesit me Pakicë

Shtojca B përmban një përshkrim të detajuar të metodologjisë që përdoret për të zhvilluar tarifat e shturura dhe përmban llogaritjen e secilit përbërës të kostos për secilën kategori tarifore. Metodologjia është prezantuar në ZRRE në procesin e rishikimit tarifor 2011 dhe aplikohet në të njëjtën mënyrë për këtë aplikim. Metodologjia mund të përmbledhet në hapat vijues:

- Pika fillestare e të HLM për vitin 2012 prej 239 milion €, siç është paraqitur në detaje në Tabelën 3.
- Çmimi i energjisë elektrike me shumicë ashtu siç është detajuar në Pjesën III të aplikimit tarifor përdoret për konsumatorët e transmisionit dhe shpërndarjes
- Tarifat SHSSH, ashtu siç janë dokumentuar në Pjesën IV të aplikimit tarifor janë caktuar bazuar në nivelin e tensionit
- Taksat e transmisionit janë llogaritur për nivelet e shërbimit 220 KV, 110 KV, 35 KV, 10 KV, dhe 0.4 KV
- Kostot e furnizimit janë shpërndarë në nivelet e tensionit me pakicë.
- Subvencioni i importit është alokuar vetëm tek konsumatorët e amvisëritë.

Lexuesi është inkurajuar për të rishikuar Shtojcën B për llogaritje të detajuara. Tabela 4 përmban një përmbledhje të kostove të shturura sipas niveleve të tensionit.

**Tabela 4 – Kostot e Shturura sipas Nivelit të Tensionit**

	<b><u>Përmbledhja e Rezultateve të Kostove të Shturura</u></b>					
	<b>220</b>	<b>110 KV</b>	<b>35 KV</b>	<b>10 KV</b>	<b>0.4 KV</b>	<b>TOTALI</b>
MWH të faturuara	657,000	87,600	40,100	205,000	2,665,841	3,655,541
Kostot në euro centë për kWh						
Kostoja e Energjisë	3.86	3.86	3.87	3.87	3.87	
Kostot e Transmisionit	0.09	0.18	0.25	0.29	0.37	
Ngarkesat e DUOS	0.00	0.00	1.01	1.65	3.14	
Ngarkesat e Furnizimit:	0.00	0.00	0.04	0.06	0.45	
Subvencioni i Energjise se Importuar					(0.49)	
<b>Totali i Kostove për Nivelin e Tensionit</b>	<b>3.96</b>	<b>4.05</b>	<b>5.17</b>	<b>5.87</b>	<b>7.34</b>	<b>6.55</b>
<b>Subvencioni që përjashton koston</b>	<b>3.96</b>	<b>4.05</b>	<b>5.17</b>	<b>5.87</b>	<b>7.83</b>	
Të hyrat në mijëra euro	26,001	3,544	2,075	12,026	195,624	<b>239,269</b>

Siç e tregon tabela e mësipërme, tarifat e shturura mbulojnë të Hyrat e Lejuara të kërkuara prej 239 milion €, kur aplikohen në shitjet prej Bilancit Energjetik. Tarifa 0.4 KV është shturur më tej për secilën kategori të konsumatorëve (të mëdhenj komercialë, të vegjël komercialë, ndriçimi publik dhe amvisëritë) për shkak të faktit se subvencioni për energji të importuar është alokuar vetëm për kategorinë e amvisërive. Ai informacion është përdorur në zhvillimin e tarifave kosto reflektive, të cilat do të përshkruhen në Seksionin V në vijim.

#### **V. Përcaktimi i Çmimeve Kosto Reflektive sipas Grupit Tarifor**

Kostot e shturura krahasohen me tarifën mesatare aktuale për secilën kategori tarifore me pakicë, për të përcaktuar shkallën në të cilën tarifat aktuale e mbulojnë koston për ofrim shërbimi. Tabela 5 paraqet tarifën kosto reflektive (në euro centë për KWh) në tarifën mesatare aktuale sipas nivelit të tensionit. Ajo tregon që tarifat aktuale 220, 110, 35, dhe 10 KV mbulojnë më shumë se koston (nga 4 për 18%) derisa tarifat 0.4 KV në total mbulojnë vetëm 75% të koston. Kur kjo aplikohet në shitjet e parapara në Bilancin Energjetik, ne mund të përcaktojmë shumën e koston në euro, e cila shërben për të krahasuar me të hyrat e parapara, ashtu siç është paraqitur në fund të tabelës.

**Tabela 5 – Çmimet Kosto Reflektive Krahasuar me Çmimet Aktuale**

**Krahasimi i Tarifave Reflektive të Kostos sipas nivelit të tensionit në tarifat aktuale:**

	<b>220</b>	<b>110 KV</b>	<b>35 KV</b>	<b>10 KV</b>	<b>0.4 KV</b>	<b>TOTALI</b>
Reflektive të Kostos	3.96	4.05	5.17	5.87	7.34	6.55
Tarifat Mesatare Aktuale	4.23	4.20	6.13	6.54	5.51	5.31
Aktualisht si % e Kostos Reflektive	107%	104%	118%	112%	75%	81%
MWH te faturuara	657,000	87,600	40,100	205,000	2,665,841	3,655,541
Të hyrat në tarifën Reflektive të Kostos	26,001	3,544	2,075	12,026	195,624	239,269
Të hyrat në tarifën Aktuale	27,791	3,678	2,458	13,411	146,916	194,254
Diferenca	1,790	134	383	1,385	(48,708)	(45,015)
	7%	4%	18%	12%	-25%	-19%

Një analizë e mëtutjeshme është bërë për kategori të ndryshme shërbimi në 0.4 KV. Ashtu siç është paraqitur në Tabelën 6 në vijim, konsumatorët e Mëdhenj Komercialë paguajnë pak nën koston, derisa konsumatorët e Vegjël Komercialë dhe Ndryshimi Publik paguajnë 10 deri 11% mbi kosto. Kategoria e amvisërive, e cila shpenzon 56% të të gjithë energjisë me pakicë (përfshirë transmisionin) paguan vetëm 65% të koston për shërbimin e tyre. Kjo është përveç faktit se tërë subvencionin i Qeverisë për energjinë e importuar (13 milion €) është alokuar për ta. Ata ende janë me 52 milion € mungesë për mbulimin e koston së tyre.

**Tabela 6 – Çmimet Kosto Reflektive Krahasuar me Çmimet Aktuale për Kategoritë e Konsumatorëve 0.4KV**

**Krahasimi i Tarifave Reflektive të Kostos për Klasat e Konsumatorëve 0.4 kV:**

	<b>Komercialët e mëdhenj</b>	<b>Komercialët e vegjël</b>	<b>Ndryshimi Publik</b>	<b>Të gjitha amvisëritë</b>	<b>TOTALI</b>
Kosto Reflektive	7.83	7.83	7.83	7.18	7.34
Tarifat Mesatare Aktuale	7.61	8.66	8.60	4.64	5.51
Tarifa Aktuale si % e Reflektimit të Kostos	97%	111%	110%	65%	75%
MWH e faturuara	223,567	401,214	12,400	2,028,661	2,665,842
Të Hyrat në Tarifën Reflektive të Kostos	17,496	31,398	970	145,759	195,624
Të hyrat në Tarifën Aktuale	17,015	34,762	1,067	94,072	146,916
Diferenca	(481)	3,364	97	(51,687)	(48,708)
	-3%	11%	10%	-35%	-25%

Ky informacion do të përdoret për të bërë ndryshimet e rekomanduara në secilën kategori tarifore.

**VI. Rregullimet e Rekomanduara sipas Grupit Tarifor**

Objektiva e rregullimit tarifor duhet të jetë lëvizja e secilës kategori tarifore më afër koston për shërbimin e asaj kategorie, derisa të HLM mbulohej plotësisht. Problemi në Kosovë qëndron se çmimet për kategorinë tarifore më të madhe, konsumatorët shtëpiakë, kanë qenë artificialisht të ulëta dhe ndryshimet e mëparshme tarifore nuk e kanë korrigjuar situatën, mirëpo e kanë përkeqësuar atë edhe më tej. Nëse Kosova pret që të plotësojë objektiven e specifikuar në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, i cili specifikon se “Subvencionet e tërthorta do të ribalancohen në mënyrë graduale deri më 31 dhjetor 2014, prej kur e tutje nuk do të ketë më subvencione të tërthorta”, atëherë tarifat e amvisërive duhet të rriten për një përqindje shumë më të madhe sesa niveli i përgjithshëm i rritjeve të koston. Një objektivë e mirë do të ishte lëvizja e tarifave të amvisërive 12% më afër nivelit të koston reflektive në secilin prej 3 viteve të ardhshme (2012, 2013, dhe 2014) meqë ato aktualisht po i mbulojnë vetë, 65% të koston.

Tabela 7 paraqet një metodë për mbulimin e totalit të HLM prej 239 milion €, përderisa i eliminon disa prej subvencioneve të tërthorta te konsumatorët e amvisërisë. Kërkohej që tarifat e amvisërisë të rriten rreth 50% më shumë se rritja e përqindjes së përgjithshme.

**Tabela 7 – Metodologjia për mbulimin e HLM të Propozuar për vitin 2012**

Kategoria Tarifore	Te hyrat ne tarifat ekzistuese	Te hyrat Kosto reflektuese	Indeksi i Mbulimit te Kostos	Rritja e Propozuar	Te hyrat e propozuara 2012	Indeksi i propozuar i mbulimit
220kV	27,791	26,001	1.07	10%	30,570	1.18
110 KV	3,678	3,544	1.04	10%	4,046	1.14
35 KV	2,458	2,075	1.18	10%	2,704	1.30
10 KV	13,411	12,026	1.12	11%	14,886	1.24
Komercial te medhenje	17,015	17,496	0.97	20%	20,418	1.17
Komercial te vegjel	34,762	31,398	1.11	15%	39,976	1.27
Shtepiak - Matesi 2 tarifor	86,446	135,644	0.64	34%	115,535	0.85
Shtepiak - Matesi 1 tarifor	6,645	8,839	0.75	30%	8,639	0.98
Shtepiak - Pamates	981	1,269	0.77	30%	1,275	1.01
Ndriqimi publik	1,067	970	1.10	14%	1,216	1.25
<b>Total</b>	<b>194,254</b>	<b>239,262</b>	<b>0.81</b>		<b>239,265</b>	<b>1.00</b>
<b>Ngritja e Kerkuar</b>		<b>45,008</b>				
		<b>23.2%</b>				

KEK-u e kupton se ZRRE mund ta konsiderojë si të papranueshme në aspektin social rritjen e tarifave për 23% në përgjithësi dhe tarifave të amvisërisë prej 34%. Në rast se total HLM për vitin 2012 nuk mund të përfshihet në tarifat me pakicë, KEK-u propozon që ZRRE të përdor një mekanizëm “zbutës” transparent për parandalimin e rritjes së madhe në çmime. Koncepti i zbutjes përfshihet në rregullat e reja për vendosjen e çmimeve, megjithatë metoda e përdorur për zbutje në vendet shumë të zhvilluara nuk është e përshtatshme për Kosovën ku çmimet janë aq të ulta.

KEK-u propozon që zbutja të arrihet me anë të “Shtyrjes” së një pjese të të Ardhurave të Lejuara të secilit të licencuar nga viti 2012 në vitet e ardhshme. Ky propozim nuk duhet të shihet si fakt përsëritës për shqyrtimet e ardhshme tarifore. Shuma e shtyrë do të shtohet automatikisht në HLM në vitin 2014 dhe 2015 bashkë me koston e huamarrjes afatshkurtër (10%). Shumat e propozuara për t’u shtyrë janë paraqitur si në vijim, në rast se ZRRE përcakton se rritja tarifore prej 45 milion € (23%) do të zvogëlohet në 23 milion € (12%):

